VENDIM
Nr. 197, datë 24.11.2017

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 134, DATË 24.12.2014, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "A&A GROUP" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 16 dhe 104, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; nenit 15 të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 4.4 të licencës së furnizimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 134, datë 24.12.2014, "Për licencimin e shoqërisë "A&A Group" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "A&A Group" sh.p.k., me shkresën nr. 663 prot. të ERE-s, datë 9.10.2017, ka njoftuar ERE-n për ndërrimin e administratorit dhe aksionarëve të të licencuarit.

- Shoqëria "A&A Group" sh.p.k. është licencuar nga bordi i ERE-s në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit nr. 134, datë 24.12.2014 dhe disponon licencën me nr. 259, seria FK14, për një periudhë 5-vjeçare.

- Rezulton se subjekti ka njoftuar ERE-n pas 8 (tetë) muajsh, për ndryshimet në shoqëri, në kundërshtim kjo me pikën 4.4 të licencës së furnizimit, ku parashikohet se i licencuari duhet të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve. Shkelja e këtij detyrimi nga i licencuari sjell si pasojë heqjen e licencës nga ERE.

- Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari/ortaku që kontrollon interesin ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 134, datë 24.12.2014, të bordit të ERE-s, "Për licencimin e shoqërisë "A&A Group" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Licenca me nr. 259, seria FK14, e shoqërisë "A&A Group" sh.p.k., bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti